

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“NAIMI&GZIMI”SH.P.K

Sot, me datë 23/07/2024 në mbështetje të legjislacionit shqiptar respektivisht ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, themeluesit:

NAIM ALIJA, shtetas Gjerman, lindur në Godanc i poshtem dhe banues në Gjermani me adrese 40547 Dusseldorf, Niederkasseler str 108 lindur më 16/11/1975, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, Identifikuar me nr personal L6WLG4XTT,

GZIM MORINA, shtetas Gjerman, lindur në PRISHTINE dhe banues në Gjermani ne adresen 40545 Dusseldorf, Oberkasseler, str 59 lindur më 27/04/1977, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, Identifikuar me nr personal L15NXP9FP,

në cilësinë e ortakëve themelues kanë vendosur të krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e emërtuar “NAIMI&GZIMI” Sh.p.k.

KREU I

NENI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- 1.1 Krijohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, sipas ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe aktet tjera ligjore që janë në fuqi.
- 1.2 Akti i themelimit është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, rregullohen nga statuti, nga ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe legjislacioni shqiptar si dhe në kontrata respektive.

NENI 2

EMËRTIMI I SHOQËRISË

2.1. Shoqëria mban emrin “NAIMI&GZIMI” Sh.p.k dhe është person juridik shqiptar.

2.2. Shoqëria “NAIMI&GZIMI” Sh.p.k (ne vijim “Shoqëria”) krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortakët e kompanisë janë :

NAIM ALIJA, shtetas Gjerman, lindur në Godanc i poshtem dhe banues në Gjermani me adrese 40547 Dusseldorf, Niederkasseler str 108 lindur më 16/11/1975, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, Identifikuar me nr personal L6WLG4XTT,

GZIM MORINA, shtetas Gjerman, lindur në PRISHTINE dhe banues në Gjermani ne adresen 40545 Dusseldorf, Oberkasseler, str 59 lindur më 27/04/1977, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, Identifikuar me nr personal L15NXP9FP,

NENI 3

SELIA E SHOQËRISË

(1) 3.1. Shoqëria e ka qendrën në "Lezhe, Tale 2, Njesia Administrative Shenkoll, are në pasurinë me nr. 25/263, Zona Kadastrale 3968, Lezhe" dhe gëzon të drejtën për të hapur filiale ose degë të tjera në Shqipëri dhe jashtë saj.

3.2. Njësitë strukturore, degët dhe përfaqësitë do të ndërtohen konform legjislacionit shqiptar në fuqi dhe me atë të vendeve të tjera ku ajo mund të hapë degë.

NENI 4

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

4.1. Shoqëria "NAIMI&GZIMI" Sh.p.k do të ushtrojë aktivitetin ekonomik të saj, për një periudhë kohe të pakufizuar nga data e regjistrimit të saj pranë Q.K.R., .

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

5.1. Shoqëria është themeluar për të vepruar me këtë objekt veprimtarie:

- Shitblerje pasuri të paluajtshme

5.2. Aktivitetet e sipërpërmendura do të realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar në fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, të miratuar nga Asambleja e Ortakëve të shoqërisë.

NENI 6

PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE

6.1. Pjesëmarrja në shoqëri nuk pengon pavarësinë ligjore, organizative dhe të pronësive së ortakëve.

6.2. Ortakët që marrin pjesë në këtë shoqëri, nuk janë përgjegjës për detyrimet që lindin gjatë aktivitetit tregtar të shoqërisë, tej kapitalit themeltar të saj, që vetë ata kanë nënshkruar, gjithashtu shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet personale të ortakëve të saj.

KREU II

NENI 7

KAPITALI I SHOQËRISË

7.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 leke (Dhjetemijë) lekë dhe përbëhet nga numri i kuotave 2 (dy) dhe me vlerë nominale dhe me përqindje si më poshtë:

NAIM ALIJA- vlerë nominale 5.000 lekë / përqindje 50 % / 1 (një) kuote.

GZIM MORINA - vlerë nominale 5.000 lekë / përqindje 50 % / 1 (një) kuote.

Kapitali mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të asamblesë së ortakëve themelues. Kuota e Pjesëmarrësve në kapital janë të gjitha të emruara dhe të pa ndashme. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Cdo kuotë i takon e drejta e një vote.

NENI 8

8.1. Në librin e llogarisë që do të krijohet në shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar do të shënohet kapitali derdhur nga ortakët e shoqërisë. Rritja dhe zvogëlimi i kapitalit fillestar të shoqërisë përcaktohet sipas rregullave të përcaktuara në statutin e shoqërisë me Vendim të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 9

SHLYERJA E KAPITALIT THEMELTAR

9.1. Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga ortakët e shoqërisë.

KREU III

NENI 10

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

10.1. Asambleja e Përgjithshme.

Administratori ose administratorët e shoqërisë.

10.2. Modalitetet dhe procedurat e emërimit, shkarkimit, kohëzgjatja e mandatit dhe kompetencat e administratorit caktohen në statutin e shoqërisë.

10.3. Administratori i shoqërisë emërohetz. **NAIM ALIJA**, shtetas Gjerman, lindur në Godanc i poshtem dhe banues në Gjermani me adrese 40547 Dussedorf, Niederkasseler str 108 lindur më 16/11/1975, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, Identifikuar me nr personal L6WLG4XTT, i cili do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar.

NENI 11

TË PËRGJITHSHME

11.1. Shoqëria do të ketë simbolet dhe vulën e saj personale, ku janë shënuar inicialet e saj të emërtimit të saj. Fillimin e aktivitetit të saj tregtar kjo shoqëri e lidh me regjistrimin pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe me marrjen e NIPT-it përkatës.

NENI 12

12.1. Dispozita më të hollësishme janë parashikuar në Statutin e kësaj shoqërie, i cili shpreh vullnetin e lirë të themeluesve.

NENI 13

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE


13.1. Ky Akt-Themelimi u redaktua në 3 kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë juridike.

ORTA KET E

ISHOQËRISË MË PËRGJEGJËSITË KUFIZUAR

“NAIMI & GZIMI”

z. NAIM ALIJA

Naim Alija


z. GZIM MORINA

Gzim Morina

*Gzim Morina*³
